

## **SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË, PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE**

Në zbatim të nenit 21, të Kreut IV, të nenit 26, të Kreut V, të ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit Nr.242, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, si dhe Urdhrit Nr.106 datë 22.05.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për “Hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e nivelit të mesëm drejtues”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, shpall procedurën e pranimit në kategorinë e nivelit të mesëm drejtues si më poshtë:

- **2 (dy) vende në pozicionin Këshilltar, në Njësinë e Shërbimeve të Përgjithshme Ligjore, në Drejtorinë e Shërbimeve të Përgjithshme Ligjore, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, kategoria e pagës II-b.**

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil.

**PËR TË TRE PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË, PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL ) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

**01.06.2023**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për: **LËVIZJE PARALELE**

---

**07.06.2023**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për: **NGRITJE NË DETYRË**

---

**07.06.2023**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për: **PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

## **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:**

---

1. Ndjek dhe përditëson njohuritë profesionale rreth kuadrit ligjor dhe zhvillimeve të jurisprudencës, relevante për punën e Këshillit;
2. Përfaqëson Këshillin e Lartë të Prokurorisë në Gjykatë në çështjet gjyqësore, të cilat përfshijnë institucionin. Ndjek të gjitha procedurat ligjore me qëllim zgjidhjen e rasteve, si dhe informon Drejtorin e Njesisë së Shërbimeve të Përgjithshme Ligjore për ecurinë e tyre;
3. Informon Drejtorin e Drejtorisë/Njesisë drejtpërsëdrejti (si verbalisht ose në formë elektronike), në mënyrë periodike, mbi informacionet e përgatitura (prapësime, konkluzione, ankime, vendime etj.), për çështjet që shqyrtohen në gjykatë, në takime pune, konferenca etj;
4. Shqyrton kërkesat/ankesat administrative, për çështje që lidhen me fushën e veprimtarisë së njesisë/drejtorisë, në zbatim të legjislacionit në fuqi, dhe jep përgjigje lidhur me to;
5. Mbështet dhe siguron asistencë juridike mbi çështjet që kërkohen për t'u trajtuar në ushtrimin e funksioneve dhe kryerjen e detyrave të të gjitha strukturave të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
6. Administron, përgatit dokumentacionin dhe ndjek të gjithë procedurën ligjore për çështjet gjyqësore, në të cilat Këshilli i Lartë i Prokurorisë është palë në proces në Gjykatë, duke respektuar afatet sipas legjislacionit në fuqi;
7. Siguron që të gjitha proceset që lidhen me përgatitjen e përfaqësimit të çështjeve në gjykatë, si dhe detyrat e tjera të ngarkuara, të realizohen në përputhje me parashikimet e Rregullores së Brendshme të Këshillit dhe me standardet më të larta profesionale;
8. Studion dhe analizon dokumentacionin, referon bazën ligjore të saktë dhe jurisprudencën përkatëse për çështjet në shqyrtim;
9. Merr pjesë në grupe pune të ndryshme për hartimin e akteve nënligjore të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
10. Jep mendim të specializuar juridik për projekt-aktet normative të sjella nga institucionet e ndryshme të drejtësisë;
11. Jep kontribut për hartimin e ligjeve, akteve nënligjore, politikave, procedurave, opinionëve ligjore, relacioneve dhe argumenteve për ose në emër të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe komisionit përkatës;
12. Ndihmon sipas rastit, në hartimin e relacionit të çështjes relatorin, sipas radhës së punës dhe të veprimit, në funksion të detyrave të caktuara nga ana e tij;
13. Përgatit materiale sipas afateve proceduriale në zbatim të procedurave ligjore;
14. Administron me efikasitet dokumentacionin dhe aktet, inventarizon çdo dosje në administrim si dhe koordinon me Zyrën e Protokollit, për marrjen në dorëzim të këtyre dosjeve, sipas legjislacionit në fuqi;
15. Kryen detyrat, brenda profilit të punës, të ngarkuar nga eprorët në linjë vertikale.

## I. LËVIZJA PARALELE

---

### 1. KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si më poshtë vijon:**

- a) Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori II-b;
- b) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a) Të zotërojë diplomë të nivelit Master Shkencor (ose të barazvlefshëm), në Shkencat Juridike. Edhe diploma e nivelit “Bachelor”, duhet të jetë në të njëjtën fushë. Diplomat e marra jashtë vendit, duhet të jenë të njohura nga institucioni përgjegjës për njesimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) Të ketë të paktën 4 (katër) vite eksperiencë;
- c) Të ketë njohuri të një gjuhe të Bashkimit Evropian.

#### 1.1. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

---

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, brenda datës **01.06.2023**, me postë në adresën: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga: “Ana Komnena”, godina Poli i Drejtësisë, Tiranë, ose elektronikisht në adresën e email: [info@klp.al](mailto:info@klp.al), kopje të dokumenteve si më poshtë:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron;
- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard> ;
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe Diplomën Bachelor) dhe listës së notave (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Dokument për kategorinë në shërbimin civil (kategoria e mesme drejtuese, me dokument nga institucioni);
- Dokument që nuk ka masë disiplinore në fuqi, (dokument nga institucioni);
- Vlerësimin e fundit të rezultateve në punë;
- Dëshmi penaliteti ose Vetëdeklarim për vërtetimin e gjendjes gjyqësore, sipas linkut

[https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/formulari-i-vetdeklarimit\\_gjendja-gjyqesore.pdf](https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/formulari-i-vetdeklarimit_gjendja-gjyqesore.pdf)

- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ka çështje në proces;
- Dokumentacion tjetër, mbi trajnimet, kualifikimet (nëse ka);
- Dëshmi të njohurive të gjuhës së huaj;
- Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës;
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

**Mosparaqitja e plotë e dokumenteve të sipërcituara sjell skualifikimin e kandidatit.**

## **2. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

---

### **2.1 Verifikimi paraprak:**

Verifikimi paraprak i përmbushjes së kushteve të përgjithshme dhe kriterëve të veçanta në shpalljen për konkurim, do të kryhet brenda datës **02.06.2023**, në ambientet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe brenda ditës do të shpallet lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, të shpalljes për konkurim.

- Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, do të njoftohen nëpërmjet adresës së email, për shkaqet e mos kualifikimit.
- Shpallja do të bëhet në faqen zyrtare të internetit, të KLP-së dhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

## **3. FUSHA E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET KONKURIMI**

---

Kandidatët në intervistën e strukturuar me gojë, do të vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë, në lidhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Kodin e Procedurës Administrative;
- Ligjin Nr.115/2016, “Për organet e sistemit të drejtësisë” i ndryshuar;
- Ligjin Nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligjin Nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

- Ligj Nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” i ndryshuar;
- Ligj Nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin Nr.9131, datë 08.9.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”;
- Ligjin Nr.9367, datë 07.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Ligjin Nr.152/2013 “Për nëpunësit civil” i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

#### **4. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

---

Vlerësimi maksimal është **100 pikë**.

- Për dokumentacionin e dorëzuar, vlerësimin e jetëshkrimit, përvojën, trajnimet apo kualifikimet, vlerësimet individuale në punë, vlerësimi do të jetë **40 pikë**.
- Për intervistën e strukturuar me gojë, në lidhje me njohuritë, aftësitë, kompetencës për përshkrimin e pozicionit të punës, përvojën në punë, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë për karrierën, vlerësimi do të jetë **60 pikë**.

#### **5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

**Intervista e strukturuar me gojë do jetë më datë 12.06.2023 ora 10:00 në ambientet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, do të shpallet fituesi në faqen zyrtare të Këshillit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga KLP, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mailit).

#### **II. NGRITJA NE DETYRE**

---

**Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke filluar nga data 16.06.2023**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

## **1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA**

### **1.1. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë si vijon:**

- a) Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, i një kategorie më të ulët III-a ose III-a/1;
- b) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

### **1.2. Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- d) Të zotërojnë diplomë të nivelit Master Shkencor (ose të barazvlefshëm), në Shkencat Juridike. Edhe diploma e nivelit “Bachelor”, duhet të jetë në të njëjtën fushë. Diplomat e marra jashtë vendit, duhet të jenë të njohura nga institucioni përgjegjës për njesimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- e) Të ketë të paktën 4 (katër) vite eksperiencë;
- f) Të ketë njohuri të një gjuhe të Bashkimit Evropian.

## **2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, brenda datës **07.06.2023**, me postë në adresën: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga: “Ana Komnena”, godina Poli i Drejtësisë, Tiranë, ose elektronikisht në adresën e email: [info@klp.al](mailto:info@klp.al), kopje të dokumenteve si më poshtë:

- Kërkesë për aplikim në vendin e punës që konkurron;
- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard> ;
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe Diplomën Bachelor) dhe listës së notave (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Dokument për kategorinë në shërbimin civil (kategoria e mesme drejtuese, me dokument nga institucioni);
- Dokument që nuk ka masë disiplinore në fuqi, (dokument nga institucioni);
- Vlerësimin e fundit të rezultateve në punë;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore (Dëshmi Penaliteti) ose Vetëdeklarim për vërtetimin e gjendjes gjyqësore, sipas linkut [https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/formulari-i-vetdeklarimit\\_gjendja-gjyqesore.pdf](https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/formulari-i-vetdeklarimit_gjendja-gjyqesore.pdf)
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

- Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ka çështje në proces;
- Dokumentacion tjetër, mbi trajnimet, kualifikimet (nëse ka);
- Dëshmi të njohurive të gjuhës së huaj;
- Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës;
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.’

### **Mosparaqitja e plotë e dokumenteve të sipërcituara sjell skualifikimin e kandidatit**

## **3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

---

### **3.1 Verifikimi paraprak:**

Verifikimi paraprak i përmbushjes së kushteve të përgjithshme dhe kriterëve të veçanta në shpalljen për konkurim, do të kryhet pas datës **16.06.2023**, dhe do të shpallet lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, të shpalljes për konkurim.

- Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, do të njoftohen nëpërmjet adresës së email, për shkaqet e mos kualifikimit.
- Shpallja do të bëhet në faqen zyrtare të internetit, të KLP-së dhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

## **4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

---

### **4.1. Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:**

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Kodin e Procedurës Administrative;
- Ligjin Nr.115/2016, “Për organet e sistemit të drejtësisë” i ndryshuar;
- Ligjin Nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligjin Nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligj Nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” i ndryshuar;
- Ligj Nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

- Ligjin Nr.9131, datë 08.9.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”;
- Ligjin Nr.9367, datë 07.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Ligjin Nr.152/2013 “Për nëpunësit civil” i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

#### **4.2. Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me;**

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

### **5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

#### **5.1. Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

1. Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
2. Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
3. Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

### **6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLP-ja do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet nëpërmjet adresës së e-mailit. Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në faqen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për fazat e mëtejshme për:

- datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.

## **II. PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL**

---

**Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së ngritje në detyrë, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke filluar nga data 26.06.2023**



## **1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

### **1.1. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

### **1.2. Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- g) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. Diplomat e marra jashtë vendit, duhet të jenë të njohura nga institucioni përgjegjës për njesimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- h) Të paktën 4 (katër) vite eksperiencë pune;
- i) Njohuri të mira në një nga gjuhët e BE-së.

## **2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, brenda datës **07.06.2023**, me postë në adresën: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga: “Ana Komnena”, godina Poli i Drejtësisë, Tiranë, ose elektronikisht në adresën e email: [info@klp.al](mailto:info@klp.al), kopje të dokumenteve si më poshtë:

### **2.1. Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:**

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin Europass;
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ka çështje në proces;
- Dëshmi penaliteti ose Vetëdeklarim për vërtetimin e gjendjes gjyqësore, sipas linkut

[https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/formulari-i-vetdeklarimit\\_gjendja-gjyqesore.pdf](https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/formulari-i-vetdeklarimit_gjendja-gjyqesore.pdf)

- Dëshmi të njohurive të gjuhës së huaj;
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

### **3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Verifikimi paraprak i përmbushjes së kushteve të përgjithshme dhe kriterëve të veçanta në shpalljen për konkurim, do të kryhet brenda datës **26.06.2023**, në ambientet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe brenda ditës do të shpallet lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, të shpalljes për konkurim.

- Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, do të njoftohen nëpërmjet adresës së email, për shkaqet e mos kualifikimit.
- Shpallja do të bëhet në faqen zyrtare të internetit, të KLP-së dhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

### **4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

---

#### **4.1. Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:**

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Kodin e Procedurës Administrative;
- Ligjin Nr.115/2016, “Për organet e sistemit të drejtësisë” i ndryshuar;
- Ligjin Nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligjin Nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligj Nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” i ndryshuar;
- Ligj Nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin Nr.9131, datë 08.9.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”;
- Ligjin Nr.9367, datë 07.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Ligjin Nr.152/2013 “Për nëpunësit civil” i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

#### **4.2. Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me;**

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## **5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

### **5.1. Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- 1) Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- 2) Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- 3) Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

## **IV. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

---

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet nëpërmjet adresës së email-it.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit nga jashtë, do të marrin informacion në faqen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

## **V. DATA E SHPALLJES SË REZULTATEVE PËR VLERËSIMIN PËRFUNDIMTAR**

---

Lista përfundimtare e fituesve e përbërë nga kandidatët që kanë grumbulluar mbi 70 pikë, të renditur duke filluar nga ai me më shumë pikë, do të shpallet në faqen zyrtare të internetit, <http://www.klp.al> dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk janë shpallur fitues do të njoftohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore, pranë KLP-së, nëpërmjet adresës së tyre të e-mailit.

Tiranë, më 23.05.2023